DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I OPINIONEVE QYTETARE

# Tirana Solidare

## Raport përmbledhës i sondazhit




**Janar 2021**

## Përmbajtja e tabelave Faqe


*Grafiku 1. Demografia* ........ 5

*Grafiku 2. Pjesëmarrja në fushatat sensibilizuese* ........ 5

*Grafiku 3. Në çfarë forme është kontribuuar* ........ 6

*Grafiku 4. Rindërtimi i banesave të dëmtuara nga tërmeti* ........ 6

*Grafiku 5. Grumbullimi i ndihmave* ........ 7

*Grafiku 6. Fondi i kontributit vullnetar për emergjencat (nr.llogarie)* ........ 7

*Grafiku 7. Operacioni kutia (ndihma për fëmijët e prekur nga tërmeti i 26 nëntorit)* ........ 8

*Grafiku 8. Pika grumbullimi (kosha të verdhë) për të dhuruar veshje, sende etj.* ........ 8

*Grafiku 9. Adopto gjysh/e (shërbim vullnetar në banesë)* ........ 9

*Grafiku 10. Vakte në banesë për pensionistë dhe persona të vetmuar gjatë pandemisë Covid-19* ........ 9

*Grafiku 11. Qendër komunitare me shërbime multidisiplinare (për akomodimin e njerëzve në nevojë etj.)* ........ 10

*Grafiku 12. Shërbimi i vakteve ushqimore në mencat komunitare* ........ 10

*Grafiku 13. Banesa sociale* ........ 11

*Grafiku 14. A kanë dhënë impaktin e duhur fushatat ndërgjegjësuese dhe thirrjet solidarizues të Bashkisë së Tiranës* ........ 11

*Grafiku 15. A do të solidarizoheni në të ardhmen me nismat dhe iniciativat e BT-së* ........ 12

## Hyrje

Tirana, ndër tëtjera karakterizohet ngasolidariteti, bujaria dhe ndihma për njëri-tjetrin. Mbështetja që Bashkia Tiranëjep për të gjitha familjet në nevojë të kryeqytetit është një punë e përditshme. Fundviti 2019 dhe viti 2020 kanë qenë periudha të jashtëzakonshme, me 2 tërmetet e vitit 2019, si dhe pandeminë gjatë vitit 2020.

Bashkia e Tiranës është solidarizuar për t'u ardhur në ndihmë zonave të prekura më shumë nga tërmetet e vitit 2019. Përveç ndihmës me mjete dhe njerëztë dërguara në operacionet e shpëtimit në zonat e prekura, Këshilli Bashkiak miratoi edhe një fond ndihme financiare prej 100 milionë lekësh për Bashkinë e Krujës dhe në mënyrë të posaçme për Thumanën. Raste të tjera solidarizimi kanë qenë: Korça me dërgimin e ndihmavedhe rindërtimin e 4 shtëpive dhe ndihma në bazë materiale për shkollën në Morinë të Kukësit.

Falë programit të rindërtimit përfundoi me sukses proçesi i ndërtimit të gjithë shtëpive të goditura nga tërmeti i 21 shtatorit 2019. Ndërkohë po vazhdojnë punimet në kantieret e tjera të kryeqytetit, atë në lagjen 5 Maji (zona e bregut të lumit), Ndroq dhe Vaqarr ku po ndërtohen lagje të reja, ndërsa në zonat rurale po rindërtohen dhe ndërtohen nga themelet shtëpi individuale për të bërë të mundur sistemimin e familjeve të prekura nga tërmeti i 26 nëntorit. Gjithashtu ka filluar proçesi i rindërtimit të objekteve arsimore të dëmtuara

Çdo familje e prekur nga tërmeti i 26 nëntorit, shtëpia e të cilës u shpall e pabanueshme, u strehua në banesa falë programit të bonusit të qerasë të parashikuar për një vit, i mbuluar në masën 100% nga Bashkia e Tiranës.

Menaxhimi i situatës Covid-19 mund të përballohej vetëm me ngritjen e një sistemi solidar.

Nisma "Adopto një gjysh/e" çoi në ngritjen e rrjetit të vullnetarëve (mbi 1000 të rinj), si dhe bashkëpunimin me administratorët e pallateve për të bërë të mundur identifikimin e personave të moshës e tretë dhe të të rinjve që i bashkohen rrjetit të vullnetarëve. Projekti i erdhi në ndihmë kategorisë së të moshuarve në kushtet e izolimit të plotë, duke ju dërguar nëpër banesa të gjitha shërbimet përkatëse nga grupi i vullnetarëve dhe bashkëpunëtorëve që u solidarizuan me këtë projekt, të cilët ndihmonin me blerjen e ushqimeve/ilaçeve, shërbimin e vakteve pranë banesave të tyre etj.

Përveç të moshuarve pjesë e projektit ishte dhe kategoria e familjeve me ndihmë ekonomike, duke ju përgatitur kuti me ushqime bazë për 14-ditë, kjo nga kontributi i sponsorave apo njerëzve të thjeshtë që ju bashkuan thirrjes së Bashkisë Tiranë. Vendosja në dispozicion e numrit të gjelbër (0800 0888) i erdhi në ndihmë këtij projekti si dhe atyre që dolën vullnetarë, njerëz të thjeshtë apo dhe personalitete për t'i dhënë më shumë zë kësaj nisme. Bashkia organizoi në bashkëpunim me artistë të ndryshëm koncerte nëpër lagje si formë argëtimi për banorët e izoluar, me shpresën për një të ardhme sa më të mirë. Tirana në mbylljen e shekullit të parë si kryeqytet, tregoi përballimin e këtyre 2 betejave me solidaritet, frymë pozitive, sukses dhe energji për të vazhduar përpara.

**Qëllimi dhe objektivat e sondazhit**

Qëllimi i këtij sondazhi është të evidentojë nëse qytetarët janë solidarizuar me nismat e Bashkisë Tiranë për t'u ardhur në ndihmë kategorive/njerëzve në nevojë dhe si e perceptojnë angazhimin që bashkia ka patur kryesisht gjatë vitit të fundit në këtë drejtim.

Ky sondazh synon të nxjerrë në pah:

1. Masën në të cilën qytetarët janë solidarizuar me kategoritë në nevojë apo njerëzit e prekur nga fatkeqësitë natyrore dhe mënyrën si kanë kontribuar më së shumti;
2. Vlerësimin që kanë për programet dhe nismat bashkiake të cilat lidhen kryesisht me situatën pas tërmeteve 2019, pandeminë covid-2019 etj;
3. Perceptimin qytetar lidhur me impaktin e fushatave ndërgjegjësuese dhe thirrjet solidarizuese të Bashkisë Tiranë në përballimin me sukses të situatave të vitit të fundit (2019 – 2020);
4. Gatishmërinë e qytetarëve për t'u solidarizuar në të ardhmen me nismat dhe iniciativat e BT-së;
5. Sugjerime dhe komente që lidhen me këtë temë.

## REZULTATET KRYESORE TË SONDAZHIT

Nëpërmjet grafikëve, ky raport pasqyron rezultatet kryesore në total të sondazhit, ku secili zë i grafikëve të mëposhtëm shënon të dhënat në total e të gjitha intervistave të kryera, gjatë procesit të vjeljes së mendimit qytetar.

Në këtë sondazh, sipas qëllimit dhe objektivave të tij, u evidentuan çështjet e mëposhtme:

**Të dhënat mbi demografinë ( 895 qytetarë të anketuar)**

*Grafiku 1. Demografia*

*a. Gjinia*




*b. Grup-mosha (vjeç)*




*Grafiku 2. Pjesëmarrja në fushatat sensibilizuese*



*Grafiku 3. Në çfarë forme është kontribuar*




*Grafiku 4. Rindërtimi i banesave të dëmtuara nga tërmeti*



*Grafiku 5. Grumbullimi i ndihmave*




*Grafiku 6.Fondi i kontributit vullnetar për emergjencat (nr.llogarie)*



*Grafiku 7. Operacioni kutia (ndihma për fëmijët e prekur nga tërmeti i 26 nëntorit)*




*Grafiku 8. Pika grumbullimi(kosha të verdhë) për të dhuruar veshje, sende etj.*



*Grafiku 9. Adopto gjysh/e (shërbim vullnetar në banesë)*




*Grafiku 10. Vakte në banesë për pensionistë dhe persona të vetmuar gjatë pandemisë Covid-19*



*Grafiku 11. Qendër komunitare me shërbime multidisiplinare (për akomodimin e njerëzve në nevojë etj.)*




*Grafiku 12. Shërbimi i vakteve ushqimore nëmencat komunitare*



*Grafiku 13. Banesa sociale*




*Grafiku 14. A kanë dhënë impaktin e duhur fushatat ndërgjegjësuese dhe thirrjet solidarizues të Bashkisë së Tiranës*



***Grafiku 15. A do të solidarizoheni në të ardhmen me nismat dhe iniciativat e BT-së***



# ANEKS 1 – PYETËSORI I SONDAZHIT

BASHKIA
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I OPINIONEVE QYTETARE

**PYETËSOR "TIRANA SOLIDARE"**

Nr. i pyetësorit________ Tiranë, më ______/_____2020

**SEKSIONI I: Të dhëna demografike**

| Nj.A / Lagje | Gjinia | | Grup-mosha | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **F** | **M** | **18-35** | **36-50** | **51-65** | **Mbi 65** |

**SEKSIONI II: Pyetje**

1. Gjatë vitit të fundit, a jeni bërë pjesë e fushatave sensibilizuese për të kontribuuar dhe ardhur në ndihmë të kategorive në nevojë, njerëzve të prekur nga fatkeqësi natyrore (tërmetet e vitit 2019), personave të ndryshëm gjatë pandemisë covid-19 etj?

☐ Po ☐ Jo ☐ Pa përgjigje

**a)** Nëse **PO,** në çfarë forme keni kontribuuar?

☐ Vlera monetare

☐ Pako ushqimore

☐ Pako veshmbathje

☐ Bazë materiale *çadra, batanije, materiale higjeno-sanitare, lodra etj.*

☐ Vullnetarizëm *shërbim në qendrat sociale, banesë etj., për të moshuar apo njerëz të vetmuar, shpërndarje pako etj.*

☐ Dhurim gjaku

☐ Tjetër___________________________

2. Vlerësoni programet sociale dhe nismat e Bashkisë Tiranë sipas tabelës së mëposhtme?

| Nr | | Aspak mirë | Jo mirë | Mesatarisht | Mirë | Shumë mirë | Pa përgjigje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rindërtimi i banesave të dëmtuara nga tërmetet | | | | | | |
| 2 | Grumbullimi i ndihmave (pako ushqimore,veshmbathje për të prekurit nga tërmetet Korçë, Durrës, Tiranë etj.) | | | | | | |
| 3 | Fondi i kontributit vullnetar për emergjenca (nr.llogarie) | | | | | | |
| 4 | Operacioni kutia (pako të përgatitura nga fëmijët për raste festash, fatkeqësish etj.) | | | | | | |
| 5 | Pika grumbullimi (kosha të verdha) për të dhuruar veshje, sende etj. | | | | | | |
| 6 | Adopto gjysh/e (shërbim vullnetar pranë banesës) | | | | | | |
| 7 | Vakte ushqimi në banesë për pensionistë dhe persona të vetmuar gjatë pandemisë covid-19 | | | | | | |
| 8 | Qendër komunitare me shërbime multidisiplinare (për akomodimin e njerëzve në nevojë etj.) | | | | | | |
| 9 | Ofrim vakti ushqimor në mencat komunitare | | | | | | |
| 10 | Banesa Sociale | | | | | | |

3. Sipas mendimit tuaj a kanë dhënë impaktin e duhur fushatat ndërgjegjësuese dhe thirrjet solidarizuese të Bashkisë Tiranë në përballimin me sukses të situatave të vitit të fundit (2019 – 2020), për t'u ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë?

☐ Po ☐ Jo ☐ Pjesërisht ☐ Pa përgjigje

4. A do të solidarizoheni në të ardhmen me nismat dhe iniciativat e BT?

☐ Po ☐ Jo ☐ Ndoshta ☐ Pa përgjigje

5. Sugjerime dhe komente:

*Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim tëevidentojë nëse qytetarët janë solidarizuar me nismat e Bashkisë Tiranë për t'u ardhur në ndihmë kategorive/njerëzve në nevojë dhe si e perceptojnë angazhimin që bashkia ka patur kryesisht gjatë vitit të fundit në këtë drejtim.Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ligjin nr. 120/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar".*
*Ju falënderojmë për kohën që i kushtuat plotësimit të këtij pyetësori dhe për mendimet që ndatë me ne, me vlerë për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Tiranës.*

## ANEKS 2 – LITERATURA/ LEGJISLACIONI I PËRDORUR


1. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
2. Ligji nr. 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”, miratuar në datën 18.9.2014.
3. Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
4. Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"”.